# Vrau ish-bashkëshorten, arrestohet 31-vjeçari në Fier, ishte fshehur në një zonë të pyllëzuar

11 Shtator, 2021 08:42



Madhësia e tekstit:

**FIER**

Arrestohet autori i vrasjes në Fier. Gazetari Ervis Kuçaj raportoi për "BalkanWeb" se Elton Metaj, 31 vjeç është arrestuar disa orë pas krimit të rëndë në një zonë të pyllëzuar.

Pas 3 orë ndjekjesh në kushte të vështira për shkak të errësirës dhe rrezikshmërisë që kishte ky person pasi ishte i armatosur, u kap nga Policia në një zonë të pyllëzuar në fshatin Peshtan autori bashkë me armën e krimit.

Pas marrjes së njoftimit se në fshatin Zhupan, në banesën e ish-vjehrrit, shtetasi Elton Metaj ka vrarë me armë zjarri ish-bashkëshorten e tij, shtetasen Sabrina Benga, menjëherë në vendngjarje shkuan shërbimet e Policisë dhe organizuan punën për kapjen e autorit i cili ishte larguar nga vendngjarja me një motomjet.

Pas 3 orësh ndjekje, nga strukturat e DVP Fier, Forca Operacionale, Forca e Posacme "Shqiponja", shërbimet e Komisariatit të Policisë Fier në bashkëpunim dhe me 2 grupe të FNSH Fier, falë veprimeve të shpejta, të mirëorganizuara dhe profesionale, u bë i mundur lokalizimi dhe kapja e autorit në një zonë të pyllëzuar të fshatit Peshtan, bashkë me armën e krimit automatik dhe motomjetin me të cilin u largua nga vendngjarja të cilat u sekuestrua në cilësinë e provës materiale.

Në vijim të veprimeve, specialistët për Hetimin e Krimeve në Komisariatin e Policisë Fier, arrestuan në flagrancë për veprën penale "Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare" shtetasin Elton Metaj, 31 vjeç, banues në Peshtan (i dënuar më parë për veprat penale "Armëmbajtja pa leje" , "Kundërshtim i punonjësit të policisë" dhe "Dhunë në familje").

Materialet do i kalojnë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier për veprime të mëtejshme.

Për t'u bërë pjesë e grupit "**Balkanweb**" mjafton të klikoni: Join Group dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. Grupi Balkanweb

U qëllua nga ish-bashkëshorti teksa hante bukë, kjo është 23-vjeçarja që u vra në Fier (Foto)

E rëndë në Fier/ 31-vjeçari vret me armë zjarri ish-bashkëshorten, flet vëllai i viktimës: E qëlloi kur po hante bukë, në korrik kishte dalë nga burgu

Vrasje në Fier, 31-vjeçari qëllon për vdekje me armë zjarri në banesë ish- bashkëshorten

**Etiketa:** fier vrasja


## TË NGJASHME

**Vrasja e 23-vjeçares me bukë në gojë, shoqëria civile protestë në qendër të Elbasanit: Të ashpërsohet dënimi për krimet ndaj gruas**
13 Shtator, 2021

**Detaje tronditëse nga vrasja e 23-vjeçares në Fier, gazetarja: E reja është qëlluar me 7 plumba, më pas i shoqi gjuajti në ajër dhe...**
13 Shtator, 2021

Shfaq Komentet (0)

## TË FUNDIT NGA -KRONIKË

**Vizita e Merkel në Tiranë, policia merr masa: Ja të gjitha rrugët që bllokohen nesër nga ora 09:00 deri në 13:00**
13 Shtator, 2021

**SHÇBA pezullon nga detyra nënkomisarin e Policisë së Durrës, nën akuzë për shpërdorim detyre**
13 Shtator, 2021

**Sekuestrohen mbi 12 mijë euro në Kapshticë, po nxirreshin nga Shqipëria me furgon nga një grek me banim në Gjermani**
13 Shtator, 2021

**Video/ Përfshihet nga zjarri magazina e një banese të vjetër në Elbasan, tymi 'pushton' qendrën e qytetit**
13 Shtator, 2021

**Sherr mes adoleshentëve në një lokal të Tiranës, plagoset me thikë 16-vjeçari**
13 Shtator, 2021

**Vrasja e ish-policit Santiago Malko/ Nipi i Çipurit jep dëshminë për klanin 'Duka'. SPAK dyshime se Daut Elmazi do të vëzhgonte Ervis Martinajn**
Klodiana Lala | 13 Shtator, 2021

## KATEGORIA VIDEO

**"Heqja nga fusha e një 'dordoleci' politik bën që...", Minxhozi: Basha ka shansin të jetë vetvetja. Iljazaj: Çfarë do ndodhë me mbështetësit e Berishës**
13 Shtator, 2021

**Luftë me Berishën për PD? Politologu Lami: Basha mund të mbajë partinë, por vështirë të vijë në qeveri**
13 Shtator, 2021

**Vendimi për Berishën/ Iljazaj: Basha fiton elektorat gri! Lami: Ka të njëjtin stil si ish-kryetari në drejtimin e PD**
13 Shtator, 2021

**"Sot u zyrtarizua ftohja PD-LSI", politologu: PS aktroi shumë mirë. Iljazaj: Berisha nuk e fiton dot luft-ën ndaj Bashës, tani ai ka lidershipin absolut në parti**
13 Shtator, 2021



**Largimi nga seanca, Lubonja: Lulzim Basha e bëri për t'i treguar publikut se nuk ka bërë kompromis me Ramën**
13 Shtator, 2021

**"Bukë, kripë e zemër", ambasadorja e SHBA: Nëse një ditë rastis në vështirësi, do të vij në Shqipëri. Bota duhet të nxjerrë mësime nga ky vend i vogël**
13 Shtator, 2021



Download on the App Store | GET IT ON Google Play

Kerko ketu

## LAJMET E FUNDIT



**"Unë e mund Edi Ramën, pa diskutim"! Berisha nuk përjashton rikthimin në krye të PD: Ftoj Bashën të vijë në takimet e mia me simpatizantët**
13 Shtator, 2021



**"Unë e dija që donte të kthehej këtu", Ferguson tregon si e bindi Ronaldon: S'mund ta imagjinoja te Manchester City**
13 Shtator, 2021



**Premier League me katër skuadra në krye, Everton i bashkohet betejës për titull**
13 Shtator, 2021



**Blinken zbulon para Kongresit arsyet e tërheqjes së SHBA nga Afganistani: Parandalimi i pushtimin taleban do të kërkonte...**
13 Shtator, 2021



**"Këtu ka intrigë nga pushteti", Lubonja: Rama ka kapur krimin e organizuar, oligarkët dhe mediat**
13 Shtator, 2021



**Rrëfimi prekës i të përndjekurit politik për 'VOA': 30 vite në kërkim të eshtrave të babait dhe vëllait që m'i vrau regjimi komunist**
13 Shtator, 2021

NA NDIQNI NË RRJETET SOCIALE

@balkanweb




© 2021 BalkanWeb. Të gjitha të drejtat e rezervuara.